

LINDITA METALIAJ



Datëlindja: 22.09.1977

Vendlindja: Lezhë

Email: Lindita.Metaliaj@parlament.al

Jetëshkrimi:

Ka mbaruar studimet pranë Universitetit Luigj Gurakuqi, Shkodër në degën juridik. Ka përfunduar studimet master i nivelit të dytë, shkenca juridike-penale pranë Fakultetit Justiniani I-rë. Gjithashtu ajo mban licencën e avokates si dhe është certifikuar për kryerjen e veprimtarisë si përmbauese gjyqësore private. Zotëron shumë mirë gjuhën angleze dhe italiane.

Ajo ka një eksperiencë pune si inspektore në Drejtorinë e Përgjithshme të Përmbaimit në Ministrinë e Drejtësië, përmbauese gjyqësore shtetërore në Zyrën e Përmbaimit Shkodër dhe më pas zhvillon aktivitetin si përmbauese gjyqësore private me zyrë në qytetin e Lezhës.

Në nëntor të 2014 ka qenë anëtare e Këshillit Drejtues të Dhomës Kombëtare të Përmbauesve Gjyqësor Privatë.

Është zgjedhur për herë të parë deputete e Kuvendit të Shqipërisë në vitin 2017.